



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. ____ Prot

Tiranë, ____ / ____ 2018

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVE (SPECIALIST)**

Në zbatim të nenit 21, 22 dhe 23 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe të Vendimit nr.243 datë 18.03.2015 "Për Pranimin, Lëvizjen Paralele, Periudhën e Provës dhe Emërimin në Kategorinë Ekzekutive" Institucioni i Avokatit të Popullit shpall procedurat për plotësimin e vendit vakant në kategorinë ekzekutive:

1. (Një) Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit dhe Koordinimit të Projekteve në Drejtorinë e Shërbimeve ndaj Qytetarit (Kategoria III-b)

Pozicioni i mësipërm ju afrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për Procedurën e Lëvizjes Paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës të Lëvizjes Paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Pranimit në Shërbimin Civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dyja procedurat (Lëvizje Paralele dhe Pranim në Shërbimin Civil) aplikohet në të njëjtën kohë .

**Data e fundit e dorëzimit të dokumentave për Procedurën e Lëvizjes Paralele është
07.09.2018**

**Data e fundit e dorëzimit të dokumentave për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil
12.09. 2018**

Përshkrimi i punës:

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Koordinimi dhe bashkpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizatat ndërkombëtare.

Ndjekja dhe zbatimi i detyrave për organizimin e aktiviteteve në bashkpunim me zyrat homologe, organizmat ndërkombëtare Brenda dhe jashtë vendit si dhe me partner të tjerë në fushën e të drejtave të njeriut në funksion të fuqizimit dhe bashkpunimit.

Krijimi dhe mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me partner ndërkombëtarë brenda dhe jashtë vendit në ndarjen e informacionit mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri si dhe në ndarjen e raporteve të veçanta dhe rsteve specifike të trtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Ndjekja e detyrave specifike në përmbushjen e detyrimeve të Institucionit që lidhen me peocetin e integritit dhe vecanërisht me plotësimin e kriterëve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Ndjekja e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të projekteve të Institucionit të Avokatit të Popullit me mbështetje ndërkombëtare.

I-Lëvizja Paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1. Kushtet për Lëvizjen Paralele dhe kriteret e vecanta.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për Lëvizjen Paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-b)
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni)
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e vecanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” Në Shkencat Juridike / Politike./ Shkenca të Komunikimit / Gjuhët e Huaja
- Edhe Diploma e nivelit “Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë.

- Të ketë njohuri të thella të gjuhës angleze.Njohja e një gjuhe tjetër e vendeve të BE-së përbën avantazh.
- Të ketë përvojë pune të paktën mbi **3 (tre)** vjet në administratën publike.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

2. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, dokumentacionin si më poshtë vijon:

a .Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentacionin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakant/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta>

- b. Fotokopje të Diplomës;
- c. Fotokopje të Librezës së Punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- ç. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- gj. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 07.09.2018.

3.Rezultatet për fazën e verifikimit praparak:

Në datën 10.09. 2018 Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Institucionit do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare te institucionit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e Lëvizjes Paralele dhe si datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e Lëvizjes Paralele do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për arsyet e mos kualifikimit.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të ankesës.

4. Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar
- Ligji nr.8371, datë 09.07.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”
- Njohuri në lidhje me procesin e integritimit evropian.
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”
- Kodi i Procedurave Administrative
- Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të Drejtën e Informimit me Dokumentat Zyrtare”
- Ligji nr.9367, datë 7.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar
- Rregulloren e Brendshme të Institucionit të Avokatit të Popullit

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për përvojën (20 pikë), Trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pikë), si dhe çertifikimi pozitiv (10 pikë). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës (legjislativ përkatës);
- Eksperiencat e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;
- Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, institucioni i Avokatit të Popullit do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare dhe në faqen zyrtare

Të Institucionit të Avokatit të Popullit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II - Për Kandidatët që Aplikojnë nga Jashtë Sistemit në Shërbimin Civil :

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët Jashtë Sistemit të Shërbimit Civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për plotësimin e vendit vakant.

II-1. Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të Ligjit nr.152/2013, i ndryshuar:

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje ;
- _Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor”, Në Shkencat Juridike / Politike / Shkencat e Komunikimit / Gjuhët e Huaja
- Edhe Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtat fusha.
- Të ketë njohuri të thella të gjuhës angleze ;
- Njohja e një gjuhe tjetër e vendeve të BE-së përbën avantazh,
- Të ketë përvojë pune të paktën mbi 3 (tre) vjet në Administratën Publike.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

II - 2. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dokumentat si më poshtë vijon:

- a. Jetëshkrimi
- b. Fotokopje të Diplomës (përfshirë edhe Diplomën Bachelor)
- c. Fotokopje të Librezës së Punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ;

ç. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmebdura në jetëshkrimin tuaj ;

d. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);

dh. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;

e. Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me postë ose dorazi deri në datën 12.09. 2018. në Institucionin e Avokatit të Popullit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

II - 3.Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën 14.09.2018, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve e Institucionit të Avokatit të Popullit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen elektronike , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Pranimit nga Jashtë Shërbimit Civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e zhvillimit të konkursit.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e Pranimit në Shërbimin Civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë anakesë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës së kandidatëve të kualifikuar. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të ankesës.

II - 4. Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista :

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ;
- Ligji nr.8454 datë.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ;
- Ligji nr.8371, datë 9.07.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ;
- Njohuri në lidhje me procesin e integritimit evropian ;
- Ligji nr.152/2013, i ndryshuar ;
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” ;
- Kodi i Procedurave Administrative
- Ligji nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”
- Ligji nr.9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar ;

- Rregullore e Brendshme e Institucionit të Avokatit të Popullit.

II - 5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve :

Kandidatë do të vlerësohen në lidhje me :

- Vlerësimi me shkrim, deri në 60 pikë;
- Intervista e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë ;
- Jetëshkrimi, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë ;

II - 6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatë pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Adresa: Institucioni i Avokatit të Popullit, Bulevardi “Zhan; Dark” nr.2 – Tiranë.